

THEODHOROS PANGALLOS
ME PAPANDREUN NË EUROPE

BOTIMET TOENA

THEODHOROS PANGALLOS

Me Papandreun në Europë

Përktheu nga origjinali greqisht

Kristo Pulla

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2017

Autori: Θεόδωρος Πάγκαλος (Theodoros Pangallos)
Titulli në origjinal: Με τον Ανδρέα στην Ευρώπη
Botoi në greqisht: Patakis Publishers

Botuese: Irena Toçi
Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Albina Pulla
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike: Elida Stafa

ISBN 978-9928-235-65-7

© Theodoros Pangallos & Patakis Publishers
© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
E-mail: redaksia@toena.com.al
botimet.toena@gmail.com
[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

PËRMBAJTJA

NJË FJALË MIRËSEARDHJEJE NË SHQIP	7
NË VEND TË PARATHËNIES:	
DUKE NJOHUR ANDREAS PAPANDREUN	17
Drejt ndërrimit të regjimit	17
Në kërkim të së Majtës demokratike.....	21
Tre shtatori	25
Agjikator	29
NË BRUKSEL ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT, NË ATHINË	
ZËVENDËSMINISTËR I TREGTISË.....	35
BALLË PËR BALLË ME REALITETIN GREK	42
Ndodhi të vogla të Ministrisë së Tregtisë.....	43
Tentativa për reforma: që nga reklamat për lodrat e fëmijëve dhe	
lëngun natyral të portokallit, deri te siguracioni i automjeteve.....	52
Përballja me “Mobil”	61
Mësimi.....	64
PËRSHTATJA ME EUROPËN	65
Duke mësuar lojën.....	67
ZËVENDËSMINISTËR I JASHTËM.....	74
DUKE PËRMBYSUR STRATEGJINË E “DJALIT TË URTË”	84

THEODHOROS PANGALLOS

THATCHER: ANTIEUROPIANIZMI BRITANIK.....	89
Papandreu dhe Thatcher-i.....	93
Kufijtë e vetos - pësimi i Thatcher-it.....	103
Si i mbronte interesat britanike një sir	104
ANDREAS DHE FRANÇOIS	111
Lojëra që të rezervon fati	113
Në gjurmët e Atridëve: Mitterrand-i në Argos	121
CRAZI: NJË NDËRHYRJE E DOBISHME	125
Si nuk arrita të njoh Berlusconi-n	130
TAKIMI I NIVELIT TË LARTË NË RODOS (2-3 DHJETOR 1988)....	132
TAKIMI I NIVELIT TË LARTË NË KORFUZ (24-25 QERSHOR 1994).....	141
Për herë të dytë ministër Plotësues i Punëve të Jashtme	141
Kompromisi i Janinës.....	143
Në ishullin e Feakëve	146
Të papritura dhe paradokse diplomatike	158
“INCIDENTI GJERMAN” DHE URTËSIA INSTIKTIVE POPULLORE	167
NJË MINISTËR TRANSPORTI ME PIKËPAMJE TË NDRYSHME NGA KRYEMINISTRI I TIJ.....	173
“ASGJËSOJENI PANGALLOSIN”: BETEJA PËR BASHKINË E ATHINËS MË 1994.....	177
PROBLEMI QIPRIOT DHE PËRFSHIRJA E TIJ GRADUALE NË KUADRIN EUROPIAN.....	181
EPILOG	189

NJË FJALË MIRËSEARDHJEJE NË SHQIP

THEODHOR PANGALLOS duket se është nga ajo racë politikanësh që besojnë te dobia e shkrimit. Ai ka botuar shumë libra. Por ky që po marrim tani në dorë, me sa di unë, është i pari i ardhur në shqip. Pangallos është, megjithatë, një nga politikanët grekë më popullorë ndër shqiptarët. Ai e ka pohuar më shumë se një herë publikisht prejardhjen e tij arvanite. Shumë veta do të donin që popullaritetin i tij të madh ndër shqiptarët ta shpjegonin pikërisht me këtë prejardhje. Do pranuar se ky fakt ngjall një emocion te shqiptarët, të cilët ende e kanë të fortë nevojën për t'u krenuar me vitalitetin e gjenit të tyre etnik. Por përkatësia arvanite është vetëm një element kulturor, madje një element periferik, në formimin e gjerë e të qëndrueshëm të Theodhor Pangallosit. Me personalitetin e tij të fortë ai është thelbësisht grek dhe, në traditën e familjes së tij, e ka vënë gjithë jetën dhe të gjitha aftësitë e veta në shërbim të Greqisë dhe të shtetit grek. Vetëm duke e parë në këtë dritë, do të mund të shpjegohet arsyeja e vërtetë e popullaritetit të tij ndër ne shqiptarët. Si ministër

i Jashtëm i Greqisë disa herë dhe zëvendëskryeministër, ai ka pasur një vlerësim realist për rëndësinë e marrëdhënieve të afërta dhe miqësore të vendit të tij me Shqipërinë dhe ka punuar si rrallë ndonjë politikan tjetër grek i niveleve të tij për ndërtimin e këtyre marrëdhënieve mbi themele të qëndrueshme dhe perspektive. Do të përmend vetëm një shembull, atë të Traktatit të Miqësisë midis dy vendeve tona, nënshkruar në pranverë 1996, duke kapërcyer pengesa shumë të mëdha historike, siç ishte ligji absurd i luftës, i mbijetuar qysh nga koha e luftës italo-greke e vitit 1940 apo edhe tensionet diplomatike të asaj periudhe me pasojë ndezjen e pasioneve nacionaliste në të dyja anët e kufirit për shkak të agresionit në një nga postat tona kufitare të Gjirokastrës, ku humbën jetën disa ushtarakë shqiptarë. Vetëm një politikan i madh e vizionar si Pangallosi mund të ngrihej mbi këto realitete të vështira për të parë pozitivisht drejt të ardhmes.

“Nuk jam i predispozuar të paraqes një vepër historike”, e paralajmëron autori lexuesin në hyrje të librit. Po a ka shkruar ai, në fakt, një vepër historike?

Përgjigjja e parë që më vjen është se po, kjo është, megjithatë, një vepër historike. E gjithë lënda e shpalosur këtu buron, pa dyshim, nga historia e Greqisë së gjysmës së dytë të shekullit XX, me ca ndriçime aty-këtu edhe mbi historinë e ndërtimit të Bashkimit Europian, histori politike kryesisht, por edhe histori diplomatike po aq, me degëzime në historinë e zhvillimeve ekonomike dhe sociale të Greqisë

së kësaj periudhe. Theodor Pangallos duket që e njeh mirë historinë në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale dhe ka aftësinë që një njohje të tillë ta vendosë në shërbim të bërjes politike dhe diplomaci, duke zënë kështu një vend të nderuar në traditën e politikanëve të mëdhenj europianë, si De Gaule, Churchill, Adenauer, Miterrand, Andreoti e ndonjë tjetër, të cilët kanë parë te historia një çelës për të kuptuar natyrën evolucioniste të realitetit imediat dhe për t'ia përshtatur kështu më mirë strategjinë e tyre politike këtij realiteti me qëllim transformimin e tij. Në tekst gjejmë një bisedë të shkurtër, por prekëse të Papandreut me Pangallosin pikërisht lidhur me historinë. Papandreu i shpreh ministrit të vet me sinjeritet keqardhjen për veten pse nuk e njeh mirë historinë. Nënkuptimi është i qartë. Si kundërshebull i racës së Pangallosit janë gjerësisht politikanët e sotëm, ata që e shpallin veten me krenari si pragmatistë, pra që nuk kanë nevojë për kulturën historike si përvojë dhe që ne i shohim përditë çfarë politike dritëshkurtër bëjnë. Me një fjalë, kjo vepër është historike, sepse, po t'i heqësh asaj lëndën historike, besoj se nuk mbetet gjë për të qenë.

Nga ana tjetër mund të themi me po kaq siguri se jo, kjo vepër nuk është historike. Autori është një ish-profesor universiteti në Sorbonë dhe e di shumë mirë mbi çfarë kriteresh rigorozisht shkencore ndërtohet “një vepër historike”. Parë nga kjo anë, autori ia ka arritur qëllimit të librit. “Me Papandreun në Europë” nuk i plotëson kriteret për të qenë një vepër historike.

Meqenëse nuk jam shumë i dhënë pas kategorizimeve, pyetjes se çfarë është atëherë ky libër, po i përgjigjem me vetë fjalët e autorit. Në epilog ai na kujton edhe një herë se *“ngjarjet që shtjellon (ky libër) kanë një karakter të theksuar personal”*. Në krye të herës, në parathënie, na ka paralajmëruar se kjo hapësirë *“ka të bëjë me Papandreun si lider i madh i një vendi, i cili luftonte për t’u inkuadruar në procesin e integritit evropian”*. Këtë mendim ai e plotëson në epilog, kur thotë se, duke shkruar këtë libër, *“dëshiroja të rregulloja marrëdhëniet e mia me Andreas Papandreun, marrëdhënie që nuk u zhvilluan përmes lidhjeve miqësore personale, por nëpërmjet bashkëpunimit. Tani, se si ka mundësi që, duke mbetur gjithmonë në nivele qartësisht politike bashkëpunimi, të krijoj për Papandreun një dashamirësi, një mirëkuptim dhe përkushtim emocional si atë që ndieja dhe ndiej edhe sot e kësaj dite, kjo shpjegohet vetëm me personalitetin magjepsës të atij njeriu të rrallë, me veset e tij joshëse dhe aftësinë e tij rrezatuese për t’i bindur dhe ndryshuar njerëzit përreth tij.”*

Pra, në thelbin e tij, ky libër është një homazh fisnik nga ana e Theodhor Pangallosit për atin e tij politik Andreas Papandreun. Por, brenda këtij homazhi përmbledhet një përvojë e pasur politike dhe diplomatike, që është përvoja e një vendi në rrugëtimin e tij evropian. Si e tillë, kjo përvojë vlen posaçërisht për ne shqiptarët sot për të kuptuar mirë e me realizëm sfidat që kemi përpara. Nuk do të kishte dobi që unë të ritregoja apo të komentoja në këtë rast çfarë thotë

autori për idhullin e vet. I ka thënë për bukuri Pangallosi. Ju ftoj ta lexoni librin. Por ia vlen të them dy fjalë për vetë autorin, diçka, që lexuesi nuk do e gjejë në libër.

Së pari, historia politike greke dhe europiane ka e do t'i ketë një borxh të paharrueshëm Theodor Pangallosit për rolin e madh që ka luajtur në transformimin rrënjësor të të majtës greke. Ky, ndoshta, ka qenë misioni më titanik me të cilin është përballur udhëheqja e PASOK-ut. E majta greke vinte nga një e kaluar e gjatë rezistence ndaj diktaturës së juntës, rezistencë kjo e frymëzuar nga ideologjia e Marksit, e Leninit, shpesh e Stalinit e madje edhe e Trockit. Një e majtë kryesisht pro sovjetike. Kultura e saj politike ishte antikapitalizmi. Domethënë, një e majtë gjenetikisht antimondialiste, antieuropiane, anti-NATO. Parë në kontekstin e proceseve integruese europiane, e majta greke ishte izolacioniste.

PASOK-u erdhi për herë të parë në pushtet në tetor 1981. Greqia ishte tashmë edhe anëtare e Bashkimit Europian (asokohe Komuniteti Ekonomik Europian), edhe anëtare e NATO-s. A do të mbahej premtimi i dhënë gjatë fushatës për ta nxjerrë vendin nga këto dy organizata? Përgjigjja e kësaj pyetjeje dihet. Por ajo që meriton të kujtohet me respekt sot është vetëdija e re dhe sidomos guximi që pati një grup ende i vogël në udhëheqjen e kësaj partie për të ndërmarrë pa vonesën më të vogël ndryshimin e objektivave strategjikë të politikës së tyre të jashtme. Të majtët grekë ishin për herë të parë në pushtet qysh nga viti 1924. Kjo e bënte edhe

më të jashtëzakonshme përgjegjësinë e PASOK-ut lidhur me të ardhmen e vendit. Greqia do të mund të shkëputej përfundimisht nga e kaluara e vet e zezë në qoftë se edhe e majta e saj, tashmë *de facto* alternativë pushteti, do të shkëputej nga e kaluara e vet antieuropiane, antiantlantike, antimondialiste, për të afruar filozofinë dhe praktikën e vet politike me të majtën socialiste dhe socialdemokrate perëndimore. Nuk ishte fjala për një ndryshim programor në letër. Duhej ndryshuar rrënjësisht mentaliteti i bazës së partisë, që ishin qindra mijë burra e gra, shumë nga të cilët ishin persekutuar, kishin kaluar rininë nëpër burgje e kampe internimi në emër të këtyre idealeve. Në këtë kuptim, një ndërmarrje e tillë ishte titanike. Dhe ia dolën për mrekulli. PASOK-u i fitoi edhe zgjedhjet pasardhëse, katër vjet më vonë. Vetë Pangallosi, që ishte njëri nga bartësit më të fuqishëm të këtij ndryshimi, vinte i pjekur si burrë shteti, duke qenë i gatshëm të merrte përsipër përgjegjësi edhe më të mëdha në mandatin pasardhës, posaçërisht me sukses në krye të diplomacisë. Theodoros Pangallos mbetet, ndoshta, deri tani ministri i Jashtëm grek, i cili ka lënë gjurmët më të forta në diplomacinë europiane dhe më gjerë.

Së dyti, kam një vlerësim të veçantë për këtë libër. Janë të shumtë dhe në të gjitha kohërat ish-ministrat e Jashtëm që kanë shkruar kujtimet e tyre. Botime të tilla kanë tërhequr gjithmonë dhe vazhdojnë të tërheqin vëmendjen e publikut të gjerë. Puna e një ministri të Jashtëm ka një vello misteri në realitet e sidomos në imagjinatën e njerëzve. Fakt

është se ministrat e Jashtëm janë protagonistë, më së paku dëshmitarë të privilegjuar në zhvillime, ku përcaktohen marrëdhëniet e popujve dhe të shteteve midis tyre. Rrjedhimisht, ata kanë shumë për të thënë. Ish-ministrat e Jashtëm i shkruajnë zakonisht kujtimet apo autobiografitë, siç edhe Pangallosi shënon diku gjatë librit që kemi në dorë, për të dhënë versionin e tyre mbi ngjarjet ku kanë marrë pjesë. Për më tepër që edhe arkivat lidhur me këto ngjarje hapen dekada më vonë. Domethënë se historianët bashkëkohorë nuk mund të ndërhyjnë për të verifikuar saktësinë e këtyre dëshmive. Kjo është përdorur jo rrallë si një liri nga shkruerit e kujtimeve për t'i ngritur vetes një monument lavdie të pamerituar.

Në rastin e Pangallosit ndodh krejt e kundërta. Ai ka zgjedhur të na i përshkruaj në këtë libër një dorë ngjarjesh, të cilat i përbashkon fakti se i kanë ndodhur autorit, pra ai nuk i ka me të dëgjuar, por i përbashkon edhe një frymë, do të thosha demistifikuese, për punën e ministrit të Jashtëm në përditshmëri. Duke gërvishtur vernikun, Theodor Pangallos nuk ka, megjithatë, asnjë shtysë drejt karikaturës. Përkundrazi, ndihet në çdo fjalë se ai e ka dashur shumë punën që ka bërë, ka qenë në çdo sekondë i përgjegjshëm dhe respektues për nderin që përmbante posti i tij. Provë e seriozitetit të tij janë rezultatet që ka arritur në përmbushjen e detyrave që i janë besuar. Por, si një burrë me një aftësi të shëndetshme humori dhe që nuk vuan nga ndonjë kompleks - shenjë kjo e njerëzve të sigurt në vete - Pangallos, me një

modesti të madhe, zgjedh nga thesari i përvojës së tij ato lloj perlash që tregojnë se edhe puna e ministrit të Jashtëm, sado e ndritshme apo misterioze që duket nga larg, ka në të vërtetë një pjesë jo të vogël rutine dhe hamallëku dhe se ministri i Jashtëm gjendet po ashtu në situata komike të paimagjinueshme. Posaçërisht ministri i Jashtëm i një vendi të vogël, i cili edhe hallet mbi shpatulla i ka më të mëdha dhe forcat mbështetëse më të vogla. Si njeri që ka kaluar në shumë situata të ngjashme, dua ta siguroj lexuesin se ato çfarë tregon Pangallosi këtu janë krejt të besueshme. Dhe përfitoj nga rasti ta përgëzoj kolegun për këtë rrëfim, veç të tjerash edhe argëtues, i cili ndihmon për ta kuptuar karrierën e tij në mënyrë më njerëzore, ashtu si edhe karrierën time, domethënë karrierën e çdo ish-ministri të Jashtëm. Do të thosha se çmitizime të tilla e afrojnë historinë politike të vendit me bashkëkohësit, duke i bërë kështu një shërbim të sotmes dhe të ardhmes.

Më duket me vend të tërheq vëmendjen e lexuesit edhe në një aspekt: libri duket qartë që është shkruar për publikun grek, pa ndonjë prapamendim për t'u eksportuar drejt gjuhësh të tjera. Për pasojë, ka aty-këtu informacione mirëfilli lokale, domethënë greke, dhe sidomos shumë emra politikanësh, bashkëpunëtorë të Papandreut e të Pangallosit në një moment a një tjetër gjatë rrugëtimit të tyre të gjatë politik, por të panjohur për ne, "të huajt". Kjo nuk duhet të shihet si pengesë për lexuesin tonë. Ata politikanë të panjohur do të mbeten për ne edhe pasi ta kemi kthyer

faqen e fundit të librit. Ama, përmbajtja e tyre, bashkë me respektin fisnik që ruan autori për ta, është e nevojshme për të vërtetën e rrëfimit. Dhe ne kjo e vërtetë na duhet.

Një përgëzim të veçantë meriton edhe përkthyesi Kristo Pulla. Nuk ka qenë punë e lehtë kjo që ka përballuar ai. Përtej dukjes relativisht të thjeshtë të gjuhës, e vështirë për t'u përcjellë në shqip ka qenë ajo që kompozitorët e quajnë “ton” të veprës. Pangallos kishte zgjedhur për shkrimin e vet një ton qesëndisë, “dérision” në frëngjisht, një qesëndi dashamirëse, pa asgjë të përbashkët me zhgënjimin, shprehje e një karakteri të fortë të autorit e që ka mbetur i tillë edhe tani që është në “pension”. Dhe ia ka arritur me mjeshtëri, duke i hapur kokëçarjen më të madhe përkthyesit. Kristo Pulla, gjithashtu, ia ka arritur të na e japë në gjuhën tonë këto “dérision”-e, duke dëshmuar një mjeshtëri të denjë për të qenë ndërmjetësi midis nesh dhe Pangallosit.

BESNIK MUSTAJ
Priskë, shtator 2017

NË VEND TË PARATHËNIES:
DUKE NJOHUR ANDREAS PAPANDREUN

Drejt ndërrimit të regjimit

TË GJITHË ATA QË JANË MARRË me biografinë time e dinë që, kur isha në moshë të vogël, ende nxënës, kam qenë rekrutuar në EPON-in (Organizata e Bashkuar Panhelenike e të Rinjve) e jashtëligjshëm. Pas një anëtarësimi të shkurtër në Organizatën Rinore të EDA-s, ku herë pas here shfaqesha dhe si aleat bashkëpunues që të bija në sy, isha angazhuar në mënyrë aktive në formimin e Rinisë Llambraki. Kur u largova jashtë shtetit për studime pasuniversitare në vitin 1965, tashmë si anëtar i udhëheqjes së Rinisë Llambraki, u rekrutova menjëherë në mekanizmin ilegal të PKG-së (Partisë Komuniste Greke) dhe si rrjedhim, në vitin 1968, kur në Plenumin e 12-të të Komitetit Qendror Partia u përça, unë isha pjesëmarrës në përbërjen e zgjeruar të këtij Plenumi. Isha, madje, personi më i ri në moshë në radhët e atyre që kishin njëfarë përgjegjësie për atë ngjarje historike.

Në këtë përçarje u pozicionova në krah të të ashtuquajturve “rishqyrtues” (ose në trajtën më ofenduese “revizionistë”), që më vonë formuan byronë brenda vendit të Komitetit Qendror të PKG-së. Dhe më vonë, këta formuan PKG-në për brenda vendit, e cila pas ndryshimit të regjimit politik, u shndërrua në koalicionin e njohur dhe që sot përbëjnë shtresën kryesore të kuadrove të SIRIZA-s (Koalicioni i së Majtës Radikale).

Në vitin 1972, së bashku me Miki Theodorakin dhe me kuadro të tjerë, kishim përshtypjen se kjo përpjekje ishte futur në një rrugë pa krye. Kështu që u shkëputëm krejtësisht nga ambientet komuniste. Deri në vitin 1974 merrja pjesë në përpjekje të ndryshme që bënin qarqet socialdemokrate për formimin e një partie greke të së Majtës socialiste, me tipare demokratike të karakterit europian. Edhe para ndryshimit të regjimit, por edhe pas këtij ndryshimi, kisha kontakte me kuadro të lëvizjes antidiktatoriale, siç ishin profesor Stratis Kallogjeropoulos, Stratis Someriti, profesor Buduri, profesor Janko Sioti, profesorët Jorgos Katiforis dhe Janis Spraos. Këto kontakte luajtën një rol të rëndësishëm në përpjekjet për izolimin dhe denoncimin e juntës ushtarake. U themelua Universiteti Veror, i cili funksionoi në Gjenevë me studentë grekë që jetonin jashtë si dhe nga Greqia, dhe në këtë Universitet dha mësim ajka e intelektualëve grekë të asaj periudhe.

Sigurisht që, me gjithë atmosferën e zymtë, me përjashtime të rralla, që krijonte puna e detyrueshme jashtë

orarit si dhe plogështia e lëvizjes popullore, deri në ngjarjet e vitit 1973 në Fakultetin Juridik, kishte edhe momente të gëzuara, të cilat ia vlen të mbahen mend.

Një mesditë, Stratis Kallogjeropullos, një aristokrat nga Korfuzi, i cili gjatë periudhës kur jepte leksione në universitetin “Pantio” kishte shkruar një vepër në dy vëllime mbi të drejtat e njeriut, kishte ftuar Strati Someritin dhe Babi Protopapën për të ngrënë së bashku në shtëpinë e tij në Gjenevë dhe për të diskutuar për mundësitë e krijimit të një lëvizjeje socialdemokrate në radhët e grekëve të mërguar.

E shoqja, një grua shumë nikoqire, kishte gatuar për ne specialitetin e njohur të Korfuzit, “pasticadhën”, me salcë të kuqe dhe me shumë erëza pikante. Por dy “socialdemokratët” e tjerë vuanin, në atë periudhë, nga probleme të ndryshme dhe kishin kërkuar për të ngrënë pak mish të zier me zarzavate. Pasi u shërbyen gjellët, Stratis Kallogjeropullos, duke konstatuar se vetëm tre vetë, domethënë ai, e shoqja dhe unë, ia bën nderimet e duhura pasticadhës, zgjati dorën dhe tha me ironi: “Po mirë, duke ngrënë gjëra të ziera do të ecim drejt socializmit në Greqinë demokratike?”.

Janko Sioti vuante, që në vitet e para të jetës, nga një sëmundje e pashërueshme, dhe si pasojë, kishte probleme serioze lëvizshmërie dhe ekuilibri. Drejtonte një automjet të përshtatur posaçërisht për nevojat e tij dhe çdo lëvizje që bënte, kërkonte përpjekje të mëdha fizike dhe forcë shpirtërore. Por, me gjithë këto vështirësi, ishte i palodhur dhe shumë i zgjuar. Ia doli që të financonim Universitetin

Veror të Gjenevës me një mënyrë që ai vetë e përshkruante si “pingpong”. Ku konsistonte kjo mënyrë?

Shkonte te Këshilli Botëror i Kishave dhe u thoshte - sigurisht që i gënjente - se kishte siguruar përkrahjen ekonomike të Kantonit dhe të Universitetit të Gjenevës. Kështu që priftërinjtë ndiheshin të detyruar të kontribuonin edhe ata. Në vazhdim, shkonte te Kantoni dhe tek Universiteti dhe u thoshte se kishte siguruar - tashmë u thoshte të vërtetën - përkrahje ekonomike nga Këshilli Botëror i Kishave e kështu me radhë. Ia kishte arritur që ne të strehoheshim në konviktin e Institutit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Gjenevës, ku vetë ai jepte mësim dhe, sigurisht, meqenëse kishte numër të kufizuar dhomash, ne flnim dy veta në dhomë. Unë e ndaja dhomën time me Jani Spraoon. Ky ekonomist i jashtëzakonshëm kishte jetuar një pjesë të madhe të jetës i zhytur, në njëfarë mënyre, në detyrimet e tij akademike në Angli dhe ishte “britanizuar” plotësisht.

Kur mes nesh u krijua njëfarë afiniteti, më kritikoi ashpër se unë këmbëngulja të vija në zbatim traditën mesdhetare të *siestës* dhe menjëherë pasi haja drekë, shkoja një orë për të fjetur. Më tha se kjo që bëja nuk bënte gjë tjetër veçse paralizonte dhe shkërmoqte punën integrale që unë do të mund të përfundoja gjatë një dite. Nuk mund të kuptonte, gjithashtu, megjithëse bënte shumë vapë, se përse unë bëja dush dy apo edhe tri herë në ditë. Sipas pikëpamjeve të tij të frymëzimit britanik, një dush të shtunave ishte i mjaftueshëm për gjithë javën.

Në kërkim të së Majtës demokratike

Pas rënies së juntës dhe ndërrimit të regjimit, mora pjesë në lëvizjen e të 400-ve, që ishin kuadro të së Majtës të moshave të ndryshme, të cilët nuk donin të pozicionoheshin në atë grindje, si grindje qensh, që kishte shpërthyer midis PKG-së jashtë vendit dhe PKG-së brenda vendit. Qasja e përgjithshme që na bashkonte ishte përpjekja për t'u shkëputur nga ajo hapësirë që zinte komunizmi me idetë e tij bazë, siç ishin diktatura e proletariatit dhe pjesëmarrja në një kamp ndërkombëtar komunist. Kjo përpjekje, siç ishte e natyrshme, krijoi konfuzion dhe kaos. Madje prej saj lindi dhe një hapësirë konkrete politike që u vetëquajt "kaosi".

Sigurisht që gjendja mbetej jashtëzakonisht konfuze. Qarkullonin fjalë sipas të cilave Averof kishte nxjerrë pistoletën e tij nga sirtari dhe kishte arrestuar personalisht kreun e juntës, Ioanidhin. Kishte shumë gjasa që këto fjalë të ishin përhapur nga ata që kishte përreth ministri i atëhershëm i Mbrojtjes Kombëtare. Me mijëra oficerë, që kishin luajtur rol aktiv në mekanizmin politiko-ushtarak të juntës, mbanin akoma grada dhe ofiqe. Shumë prej tyre ishin të emëruar në poste delikate. Tri herë, të paktën, u detyrova ta kaloj natën në shtëpitë e miqve, ngaqë qarkulluan fjalë se ushtria kishte rimarrë pushtetin.

Dy ditë pasi mbërrita në Athinë, më ftoi në shtëpinë e tij, në lagjen "Psihiko", i paharruari Dhimitër Cacos. Ishte një natë e mrekullueshme e fillimgushtit. Ishte e qartë se

Cacos dëshironte të diskutonte me të ashtuquajturën, siç e quanin me ironi disa, “École de Paris”, domethënë me intelektualë grekë që kishin studiuar dhe kishin dhënë mësim në universitetet franceze dhe që kishin pak a shumë orientim marksist. Shkuam me të vërtetë në shtëpinë e tij dhe shijuam një darkë të mrekullueshme.

Nëna e tij e ndjerë, e cila qëndronte zgjuar dhe ndiqte diskutimet tona nga një ballkon i zhytur në errësi - ne hanim jashtë në kopsht - ishte një kuzhinierë e përkryer. Në fillim u shfaq në tavolinë një tepsi me specë të mbushur, të cilës të gjithë ne i bëmë nderimet që i takonin. Mbjaj mend midis të ftuarve të ndjerin Nikos Pullanxas, Kostas Cukallën, Jorgos Velcon, Dhimitër Maronitin si dhe Dhimitër Faturon. Por meqë tepsia ishte e madhe dhe ngaqë na nxiti të mos hezitoni, Dhimitër Cacos përllau shtatë copë. Unë nuk shquhem për vetëpërmbytje përpara ushqimit të shijshëm, por ajo që po shihja ma kalonte nga çdo pikëpamje.

Në vazhdim na u shërbye një peshk *sfridhë* me zarzavate të ziera, dhe në fund shijuam edhe supën. Vështroja me ankth Cacon duke pritur që në një moment do ta hiqte shaminë që mbante në qafë gjatë ngrënies dhe do të deklaronte se nuk mund të vazhdonte më, por ai moment nuk erdhi kurrë.

Në Ministrinë e Arsimit, na shpjegoi Caco, gjendja paraqitej si më poshtë: nën drejtimin e mjekut obstetër, ithtar i Mbretit dhe i Karamanlisit, Nikolaos Luross, që ishte ministër, Cacoja kishte marrë përsipër arsimin e lartë, me sekretar të përgjithshëm Dhimitër Faturon dhe sekretar

të posaçëm për programet e shkencave sociale Dhimitër Maronitin. Pra, ai kishte si synim të na punësonte si grup pune që të rishqyrtonim urgjentisht programet e shkollave ku zhvilloheshin mësimet e shkencave sociale.

Plani i tij ishte i arsyeshëm, pavarësisht karakterit të tij urgjent. Ndërkohë që ishte rivendosur demokracia, ishte e pamundur që rinia të edukohej me ato mbeturina kulturore që normalisht duhej të ishin hartuar nga servilë belpërkulur dhe me mendësi fashiste të komunitetit universitar të asaj periudhe. E filluam punën me vrull. Mua më kishin dhënë një zyrë të vogël dhe Dhimitër Maroniti, që erdhi për të më takuar, më tregoi dhe një buton nëpërmjet të cilit mund të thërrisja ndonjë nëpunës për bashkëpunim. Pra, i rashë edhe unë ziles dhe u shfaq një shkurtabiq me një palë mustaqe model *Sharlo*, i cili më deklaroi se ishte Drejtori i Përgjithshëm. Kur i kërkova të më sillte kurrikulat, domethënë programet e fakulteteve universitare, m'u përgjigj se do të bënte çdo gjë që t'i kishte brenda një jave.

M'u duk e ekzagjeruar gjithë ajo kohë, por nuk doja t'i përkeqësoja gjërat. Kisha vënë re, me njëfarë shqetësimi, se kishte veshur një palë mëngë të zeza, që të mos i hollohej këmisha te bërrylat, ndërsa në kokë mbante një kapelë të vogël, si ato që mbajnë telegrafistët në filmat e vjetër. Te jaka e xhaketës kishte vendosur një shami të bardhë, me sa kuptohet që të mos i prishej xhaketa nga djersa. Nëse më mendoni mua, që kisha veshur një palë sandale plazhi, një palë pantallona xhins, një këmishë mbi pantallona dhe një

gjerdan me lloj-lloj dhëmbë kafshësh që e kisha sjellë nga Afrika, atëherë e kuptoni se edhe shkëmbimi i vështrimeve me njëri-tjetrin ishte një peripeci më vete.

Është e tepërt t'ju them se qëndrova pothuajse një muaj në ministri, shkrova kapitullin tim mbi një propozim për reformën në arsimin e lartë që e hartuam të gjithë së bashku dhe që iu dorëzua ministrit, zotit Luro, por mikun tim me mbrojtëse të zeza për mëngët dhe shaminë e bardhë te jaka nuk e pashë kurrë më dhe, megjithëse e kërkova, nuk arrita kurrë të gjeja se në ç'vrimë ishte futur. Instinkti i tij i kulluar prej burokrati e ftonte t'u kundërvihej normave dhe rregullave të reja, që nuk mund të ishin gjë tjetër veçse të rrezikshme, pra të papranueshme.

Nisma të tjera më të detajuara, si ajo e Virxhinia Cudherusë me Georgio Aleksandro Mangakin, me Janko Pesmazoglun, me profesor Nikolaidhin, me Kosta Alavanon, çonin qartazi drejt një lloj amalgame në partinë Bashkimi i Qendrës, të përbërë nga njerëz me orientim më radikal, që e kishin të pamundur të pranonin kryetarin e partisë Georgio Mavron dhe vijën e saj politike.

Përveç kësaj, aftësitë prej lideri të Georgio Mavrosit ishin vënë në pikëpyetje të forta dhe pjesëmarrja e tij në qeveritë e epokës së pasluftës civile, nuk kishte lënë kujtime të mira te demokratët e vendit. Mavrosi ishte përgjegjësi kryesor për çështjen e njohur të Aviacionit, që poshtëroi forcat e armatosura greke dhe diskreditoi vendin në arenën ndërkombëtare.

Për fat të keq, familja e tij, për interesa personale, e çoi Mavronin deri në kufijtë e skajshëm të poshtërimit individual, duke u shfaqur në jetën politike dhe sidomos në Parlamentin Europian në një mënyrë të tillë, që arrinte në kufijtë e groteskes. Më ka mbetur në mendje një rast kur ishte duke mbajtur një fjalim në Kastelorizo, nga ishte edhe origjina e tij, që duke e vendosur çdo faqe që lexonte poshtë të tjerave, humbi kontrollin dhe filloi ta lexonte fjalimin prapë nga fillimi, derisa shoqëruesit e tij e kapën dhe e larguan nga mikrofondi.

Tre shtatori

Për Andreas Papandreun kisha rezerva serioze. Kur isha student, kisha lexuar shkrime të tij, që më kishin lënë mbresa. E kisha takuar dy herë në Paris me cilësinë e përfaqësuesit të PAM-it (Frontit Patriotik), për të diskutuar nëse dhe në çfarë mase do të duhej të zgjerohej një marrëveshje eventuale PAM-PAK edhe me elementë të së Djathtës patriotike, dhe kryesisht me Karamanlisin dhe me mbretin. Mosmarrëveshjet tona ishin absolute, megjithëse sa herë që e takoja, e kisha gjithnjë dhe më të vështirë të parashtroja argumentet e Frontit Patriotik që unë përfaqësoja. Kisha filluar të ndikohesha nga sharmi i tij që vepronte në mënyrë katalitike dhe nga aftësia për ta bërë për vete bashkëbiseduesin, madje edhe nëse biseda fillonte

nga pozicione diametralisht të kundërta. Kur përpiloja raportet për këto takime, më duhej një përpjekje e madhe intelektuale për të formuluar konkluzionin e imponuar, domethënë se me Andreasin nuk kishte hapësirë për t'u marrë vesh dhe se ndoshta, ashtu siç kisha filluar të besoja, edhe ai vetë nuk tregonte ndonjë interes të veçantë për një bashkëpunim të tillë me të Majtën komuniste.

Mbaj mend se në të dyja herët që u takuam, Andreas kërkoi të gjente portofolin dhe konstatoi se nuk kishte parë me vete, kështu që në të dyja rastet pagova unë. Vite më pas, kur e shoqëroja në një vizitë në Londër, në një prej ditëve të rralla me diell të këtij qyteti, dolëm për të shëtitur dhe pamë një tregtar ambulant që shiste *donats*, të cilat na u dukën mjaft të shijshme. Futi përsëri dorën në xhep dhe tha: “Nejse, të jam bërë qelepirtxi sistematik. A e mban mend Parisin ku pagove dy herë për kafet?”. Mbeta pa gojë. E pyeta: “Po mirë, zoti Kryetar, kaq rëndësi kishte kjo, apo mbani mend çdo gjë?”. Dhe atëherë m'u përgjigj: “Për fat të keq, mbaj mend gjithçka, përveç disa gjërave që janë të papëlqyeshme për mua. Atëherë i vendos me gjithë forcën time diku, në nënvetëdije, apo ku ta di unë se ku, dhe i harroj”. Përveç këtyre rasteve e kisha takuar edhe një herë tjetër në shkallët e zyrave të PASOK-ut, gjatë zgjedhjeve të vitit 1974.

Pikëpamja ime si anëtar i PASOK-ut tashmë, pas Proklamatës Programore të 3 shtatorit, ishte se kishim formuar një parti të vogël që do të zinte vend në të Majtën

ekstreme, domethënë aty ku ishin pozicionuar dy partitë komuniste. Frazeologjia dhe parullat e atyre zgjedhjeve më jepnin të drejtë për këtë pikëpamje që kisha.

Pra, kur takova Papandreun te shkallët, unë duke u ngjitur dhe ai duke zbritur për të dalë, ndërkohë që rezultatet e zgjedhjeve tashmë ishin të njohura, më pyeti: “Si të duken rezultatet?”. Iu përgjigja menjëherë: “Fantastike, zoti Kryetar”. “Ashtu?”, ia bëri Papandreu, “pse çfarë prisje ti domethënë?”. Unë i thashë me sinqeritet mendimin tim, domethënë se prisja një rezultat diku te 5 % ose 6 %. Që atë ditë, sa herë që në ndonjë prej forumeve të PASOK-ut diskutohej mbi zgjedhjet dhe bëheshin parashikime për to, Andreas thoshte: “Të pyesim Theodorin dhe ta shumëzojmë për tre, sepse më 1974, kur të gjithë më siguronin se nuk kishte mundësi të binim poshtë 30 %, ai më tha se priste që të fitonim 5 % të votave”.

Sigurisht, këtu duket qartë se çfarë kishte ndodhur. Ata që vinin nga Qendra kishin mbivlerësuar aftësinë e Papandreut për t’iu imponuar votuesve të partisë që në një mënyrë apo në një tjetër familjarisht i përkiste. Nga ana tjetër, unë, për shkak të prejardhjes sime komuniste, e shikoja partinë ashtu siç doja që të ishte, domethënë si një parti të majtë shumë kompakte, dhe jo siç ishte ajo në të vërtetë. Prandaj ekzistonte dhe ky ndryshim i madh midis dy parashikimeve.

Isha inkuadruar në radhët e PASOK-ut pak ditë pas Proklamatës së 3 shtatorit, besoj në datën 7 apo 8 shtator 1974. Përjetoja ditë të një ankthi të madh. Ndihesha i izoluar

dhe si në hava. Nuk mund të jetoja më ashtu si kisha jetuar, domethënë brenda kuadrit të ideologjisë komuniste dhe parakomuniste, dhe nuk isha aspak i predispozuar që të bëhesha reformator centrist. Proklamata e 3 shtatorit më dha edhe mua, ashtu si qindra mijëra grekëve të tjerë, njëfarë rrugëdaljeje nga ato zhvillime të turbullta dhe, në shumë raste, të pakuptimta të periudhës pasdiktatoriale. Mbaj mend takimin konkret në një kafene-tavernë të Elefsinës. Të pranishëm ishin Stamati Kavadhia, ish-kryetar i Qendrës Punëtore (elektricitist në fabrikën e çimentos TITAN), Tasia Marunga, një arkitekte e zjarrtë dhe e bëshme, Spiros Miras, ndërtues, Tasos Manalis, kryetar i punëtorëve të çimentos TITAN, Nikos Argjiropullos, rrobaqepës, Panajotis Lianos dhe gruaja e tij - një luftëtare e zjarrtë - së bashku me të vëllanë Miço, të gjithë punëtorë, Nikos Kariavulas, tregtar, një çift të rinjsh, Janis Krikas, student dhe Maria Mira, nxënëse gjimnazi, si edhe unë. Vendosi të formonim në Elefsinë një “bërthamë vetorganizimi”. Kjo nismë shumë shpejt mori përmasa. Na vinin mesazhe inkurajuese nga të gjitha anët. Në katër vitet pasardhëse u aktivizova në nivel vendor. U zgjodha një apo dy herë anëtar i Komisionit Koordinues dhe, në fund, u zgjodha anëtar i këshillit në rang prefekturë, ku isha emëruar përgjegjës për Sektorin e Agjitacionit.

Agjikator

Në krye të këtij sektori në zyrat qendrore të PASOK-ut, të cilave unë vazhdoja t'u shmangesha si shejtani temjanit, ishte ekonomistja e re në moshë në atë kohë, Vaso Papandreu. Një natë që binte dëborë, Vaso erdhi në Mandra që t'u shpjegonte një grupi punëtorësh të industrisë kuptimin e termit *shfrytëzim*. Ishim mbledhur në një kafene me ndriçim të dobët, dhe secili prej atyre që vinin, nxitonte të zinte vend sa më afër të vetmit burim nxehtësie që kishte aty, një sobe me dru, dhe të zgjaste duart drejt saj për t'u ngrohur. Ambienti ishte mbushur me tym duhani dhe me avuj nga çaji dhe rrobave të lagura të atyre që ishin mbledhur aty.

Në një moment mbërrita edhe unë me një automjet të vogël *Renault 4* (ose, siç e quanin në Francë, *quatrelle*), që disponoja në atë periudhë, së bashku me Vason që e kisha marrë me vete. Vasoja, e vetmja grua në atë ambient të mbushur me burra, filloi të shpjegonte nocionet dhe metodat e ndryshme të matjes së vlerës, duke iu referuar herë pas here klasikëve të marksizmit, dhe përfundoi në një përshkrim të shfrytëzimit me një metodë strikte klasike marksiste. Kur mbaroi, pyeta të pranishmit nëse dëshironte ndonjëri prej tyre të bënte ndonjë pyetje. Paso i heshtje absolute. Ca nga kërcitjet e druve në sobë, ca nga konjaku që i kishin shtënë çajit, ca nga ajo atmosferë shoqërore që krijonte njëfarë rehatie, shumë prej tyre bënë përpjekje të mëdha që t'i mbanin sytë të hapur. Atëherë e ndjeva të

nevojshme të ndërhyja dhe të jepja tre apo katër shembuj domethënës për të gjitha ato që “shoqja” kishte shpjeguar më parë.

Filloi menjëherë një diskutim i gjallë dhe intensiv, në kuadrin e të cilit, që të jemi të sigurtë, Vasoja iu imponua dhe fitoi admirimin e të gjithëve. Duke u kthyer për në Athinë, Vasoja më pyeti: “Po ti, ku aktivizohesh në parti?”. Unë iu përgjigja se ajo e dinte që drejtoja sektorin e agjitacionit në Këshillin e Prefekturës të Atikës Perëndimore, pra isha nën vartësinë e saj. Më hodhi një vështrim mosbesues, a thua se po i fshihja diçka, dhe më bëri në vazhdim një pyetje të karakterit strategjik: “Po mirë, me cilët nga udhëheqja e partisë mban kontakte? Diskuton me Jorgon (Jenimatanë), me Akin (Tsohatzopullon), me Kostën (Simitin)?”. Iu përgjigja “jo”, dhe Vasoja më detyroi t’i premtoja se tashmë do të filloja të vizitoja Komitetin e Agjitacionit, qendrën e frikshme dhe të tmerrshme të Studimeve të Agjitacionit (KEMEDIA), që mbledh një herë në javë në zyrat e reja qendrore të PASOK-ut në rrugën “Harillau Trikupi”. Ky ishte dhe integrimi im në mekanizmin qendror, siç i thoshim atëherë, i cili më solli më afër me kuadrot e larta dhe zhvillimet politike në parti.

Në vitin 1980, meqenëse isha në KEMEDIA, u përfshiva në organizimin e kongresit shtatëditor për mendimin marksist dhe problemet në ekonomi, në të cilin merrnin pjesë përfaqësues nga ajka e intelektualëve të kohës, mes të cilëve edhe Samir Amin.